Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*
- ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit, (Shtojca 7)

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet përkatësisht **2,579,940**(Dymilion e peseqind e shtatedhjetë e nentemije e nenteqind e dyzet) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2020 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2020.
4. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.3 Për kapacitetin teknik:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **1,031,976** (Njemilion e tridhjetë e njemije e nentëqind e shtatedhjetë e gjashtë) lekë , të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Si deshmi për përvojën e mëparshme kerkohen:

- a) Kur shërbimi është realizuar me Entë Publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit dhe vlera e shërbimit të realizuar.
 - a) Kur shërbimi është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera.
2. *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licënsë profesionale lëshuar nga organet perkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge, autostrada...”

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucioneve përkatëse shtetërore, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **10 (Dhjetë)**. Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme , shoqëruar me listepagesat perkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.*
4. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të pakten*

1 (nje) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri duhet të jetë i siguruar dhe të figurojë me kohë të plote në listepagesat perkatëse E-Sig për të paktën muajin e fundit

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: a) Kontratën individuale të punës, dhe b) Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

5. *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese se inxhinieri i ndertimit është i disponueshem për realizimin e kësaj kontrate.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vertetuar deklarin e mesipërm.

6. *Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, te figurojë i punësuar me kohë të plote në listëpagesa.*

Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diplomë

7. *Vetdeklarimin nga inxhinieri i ndertimit se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vertetuar deklarin e mesipërm.

8. *Vetdeklarim nga Drejtuesi Teknik se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.*

9. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në listëpagesa për muajin e fundit ,me kontrate pune (te vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:*

Teknik ndërtimi	1 (një) punonjës
Manovrator	2 (një) punonjes

Per teknikun e ndertimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar.

10. *Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë , duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:*

- *ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”, (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- *ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”

11. *Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :*

<i>Nr</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Grejder</i>	<i>1 cope</i>
2	<i>Fadrom me goma</i>	<i>1 cope</i>
3	<i>Kamion vetshkarkues mbi 10 tone(ngarkesa)</i>	<i>2 cope</i>

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- 1.Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- 2.Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- 3.Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë **ku të specifikohet afati i kontratës**, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme)
- 4.**Për cdo automjetet të paraqitet fotoja përkatëse për identifikimin e targave te mjetit.**
- 5.Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë nje deklaratë që makineritë e kerkuara ne piken 2.3.11, nuk jane të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder, por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu ne deklarate duhet te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera. **Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**
6. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me leje mjedisi tipi B, Kodi III.1.B ose ne raste se operatori ekonomik ka kontrate furnizimi , duhet te shoqeroj bashke me kontraten e furnizimit dhe leje mjedisi tipi B, Kodi III.1.B të funizuesit.Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratën e furnizimit me furnizuesin bashkë me leje mjedisi tipi B, Kodi III.1.B të funizuesit,te lidhur para noterit ,te vefshme per periudhen deri ne afatin e realizimit te kontrates .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI:

RIPARIM ME STABILIZANT TE RRUGEVE TE PA-ASFALTUARA NE BASHKINE SHKODER.

PERKUFIZIME

Rruga do të thote rruga ose rrjeti i rrugeve në administrim për të cilin janë planifikuar punimet dhe shërbimet e mirembajtjes.

Shërbimet janë të gjitha nderhyrjet në rrugë sipas planifikimit të punimeve të mirembajtjes dhe të gjitha aktivitetet që lidhen me manaxhimin dhe vlerësimin e kushteve të rrugës që do kryhen me qëllim arrijtjen edhe mbajtjen e standarteve punuese të rrugës siç përcaktohet nga nivelet e cilësisë së shërbimit.

Pagesa përfshin verifikime dhe raportime, për të gjitha pagesat, të gjitha provat, siç specifikohet në dokumentet e kontratës si dhe operacionet e kerkuara për kontrollin e vetive funksionale të produktit sipas përcaktimeve.

Pagesa do të paguhet në përputhje me çmimin njësi të specifikuar në preventiv për njësinë që është specifikuar, dhe sipas sasisë aktuale, nëse nuk është shënuar ndryshe për zerin e pagesës në specifikimet.

FUNKSIONI

Rrjeti rrugor i rrugëve që janë në administrim të Bashkisë Shkoder, përbëhet nga :

- a. Rrjeti i rrugëve urbane të qytetit.
- b. Rrjeti i rrugëve rurale dhe lokale në njesite administrative të cilët lidhin qendrat e njesive

administrative me bashkine, njesite administrative me rruget kombetare, qendrat e fshatrave me njesite administrative si dhe fshatrat dhe lagjet e tyre me njeri tjetrin brenda njesive administrative.

VENDNDODHJA

Rruget rurale dhe lokale te bashkise Shkoder, shtrihen ne te gjithe territorin e saje ne Qytet dhe Njesite Administrative Postribe, Rrethina, Guri i Zi, Berdice, Ana e Malit, Dajç, Velipoje dhe Pult, Shosh, Shale. Në inventarin e rrugëve një pjesë e konsiderueshme janë rrugë të pa-asfaltuara të cilat kanë lëvizshmëri të lartë nga banorët dhe përdoruesit e tjerë duke përfshi edhe biznese.

Në këto kushte eshte e domosdoshme te perfshihen punimet per riparimin kryesisht ne ato rruge të cilat paraqesin më tepër problematike për përdoruesit e tyre si dhe kanë impakt në përmiresimin e qarkullimit per banoret dhe bizneset. Këto rrugë lidhin territore te njesive administrative me bashkine, njesite administrative me rruget kombetare, qendrat e fshatrave me njesite administrative si dhe fshatrat me njeri tjetrin brenda njesive administrative, si dhe rrugë te tjera te qytetit te Shkodres qe shtrihen ne 5-lagjet e qytetit dhe jane rruge kryesisht periferike te zonave informale te populluara nga banore pas viteve 1990.

PROBLEMATIKA

Problematika e ketyre rrugeve eshte sepse ka shume gropa si rezultat i rreshjeve dhe ngricave. Janë krijuar karregjata nga levizja e mjeteve dhe perdorimi i tyre duke e veshtiresuar kalimin. Demtimet teknike ne trupin e rruges kane ardhur edhe nga mungesa apo bllokimi i kanaleve anesore te kullimit dhe drenazhimit si dhe prurjeve anesore te perrenjve ne zonat kodrinore. Duke qene se ne disa raste ne trupin e rruges kane vershuar ujrat anesore (duke bere qe vete trupi rruges te sherbeje si kanal kullues), jane krijuar karregjata te cilat jane bere shkak per veshtiresi qarkullimi te automjeteve.

Ne keto segmente rrugore nga mos funksionimi i kanaleve anesore te grumbullimit te ujrave sipërfaqesore dhe ujrave te larta qe vijne nga skarpatat e rruges dhe qe bejne largimin e tyre nepermjet veprave te artit si ura te vogla apo tombino, pervec mbushjeve me inerte qe kane sjellur perrenjte jane krijuar demtime te medha ne drejtim terthor dhe gjatesor te trupit te rruges. Nga rreshjet e shumta te shiut dhe prurjeve te medha nga perrenjte anesore rruga eshte kthyer ne kanal duke bere edhe demtime nga ana teknike te trupit te rruges.

Materialet inerte (stabilizanti) do te perdoret per riparimin dhe mirmbajtjen e rrugeve te pa asfaltuara te cilat kalojne ne terrene kodrinore dhe fushore ne njesite administrative.

Pervec demtimeve te niveletes te rruges dhe kanaleve anesore nga rreshjet e shumta te shiut dhe prurjet anesore, jane krijuar edhe demtime teknike ne trupin e rruges te cilat e bejne te rrezikshem kalimin nga përdoruesit.

Pervec mbushjeve me dhera qe kane sjellur prurjet e shiut jane krijuar demtime te medha ne drejtim terthor dhe gjatesor te trupit te rruges duke krijuar karregjata te cilat jane bere shkak per veshtiresi qarkullimi te automjeteve. Shtresat me inerte të trupit te rruges jane gerryer nga ujrat sipërfaqesore qe kalojne ne niveleten e rruges duke nxjerre materialet shkembore te cilat veshtiresojne se tepermi levizjen e mjeteve ku ne shume raste rruga mund te jete problematike dhe mbart rrezik te madh per përdoruesit.

Gjithashtu shkak kryesor i demtimit te rrugeve te pa asfaltuara jane bere edhe ndertimet me objekte apo mure rrethuese te cilat kane bllokuar kanalet kulluese dhe ne keto raste rruga eshte kthyer ne nje kanal ku ujrat e shiut kalojne ne trupin e rruges duke shkaktuar gerryerje dhe demtuar ne

niveleten e rruges.

Te gjitha keto kane sjellur veshtiresi te medha ne qarkullimin e automjeteve si dhe rrezik permanent sigurie kalimi nga perdoruesit e saje.

STABILIZANTI

Shtresat e stabilizantit duhet të plotesojne keto kushte:

- Indeksi I plasticitetit nuk duhet te kaloje 10.
- Nuk duhet te permbaje grimca me te madhe se 2/3 e shtreses ne sasi mbi 5%.
- Nuk duhet te permbaje mbi 10% grimca argjilore. Trashesia e shtreses te kasonetes do te jete jo me teper se 150 mm.
- Perberja granulometrike per furnizimin do te jete: Fraksioni 0-37mm.
- Siperfaqja e perfunduar e ngjeshur nuk duhet te kaloje ± 40 mm.
- Inertet e trasha do te perbehen nga material guri te thyer apo te nxjerre ose nje kombinim I tyre me nje mase jo me shume se 37 mm dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substance te tjera te demshme.
- Lendet demtuese ne inertet e trasha nuk duhet te kalojne me shume se 3%.

RRADHA E PUNIMEVE TE SHERBIMIT

Punimet duhet te perqendohen kryesisht ne keto procese pune:

1. Largimi i inerteve dhe dherave nga trupit te rruges te sjella nga rreshjet e shiut si dhe prurjet e tjera anesore.
2. Germimi i mbushjeve nga inertet te kanaleve per largimin e ujrave dhe sistemimin e tyre ne tombino aty ku ekzistojne qe ujrat e tepert te mos shtrihen ne trupin e rruges per demtimin dhe gerryerjen e saje.
3. Nivelimin e trasese se rruges per drejtimin e niveletes duke drejtuar karrexhatat, gropat dhe demtimet e tjera ne trupin e rruges te cilet rrezikojne perdoruesit e rruges.
4. Mbushjen me stabilizant dhe rrafshimin e trupit te rruges me makineri.
5. Perqendrimi i punimeve duhet te behet kryesisht ne pjeset rrugore te atyre segmenteve i cili vleresohet nga grupi i ndjekjes se punimeve si me i demtuar dhe i domosdoshem dhe qe paraqet impakt me te madh ne rritjen e sigurise rrugore dhe permiresimin e qarkullimit nga perdoruesit.

ZBATIMI I PROGRAMIT TE SHERBIMIT

Sipërmarrësit nuk do t'i bëhet asnjë pagesë mbi çmimet njësi të kuotuarat ne preventiva për kostot e mobilizimit, sigurimit te transportit, realizimit d.m.th. deri ne perfundim te punimeve, perveç atyre te ofertes.

Me nenshkrimin e kontrates se punimeve, sipërmarrësi ne bashkepunim me grupin e ndjekjes se punimeve duhet te hartojte grafikun e nderhyrjeve.

Per rruget qe do te riparohen, mqs kushtet atmosferike krijojne ndryshime te situates se rrugeve

nga momenti vleresimit deri ne periudhen e nderhyrjes per riparim, grupi i ndjekjes do te hartoje kalendarin e nderhyrjeve perfundimtar sipas situates ne momentin qe do te punohet.

Periudha e realizimit te punimeve te sherbimit dhe mirmbajtjes do te jete 12 (dymbedhjet) muaj nga lidhja e kontrates, sipas nevojave dhe investigimeve te administratoreve te njesive administrative.

Vlera eshte miratuar sipas V.K.B. Nr.63, date 28.12.2020, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”, projekti: P04520.O3.A1. (Mirmbajtja e rrugeve rurale).

Zerat e punimet jane ne preventivin e hartuar nga Bashkia sipas “Manualit teknik te punimeve te ndertimit dhe analizave teknike te tyre”, miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 dhe skicave e projekteve te Bashkise.

Kontraktori ne bashkepunim me supervizorin do te hartojne dokumentacionin teknik, në mbështetje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“ në mbështetje të udhëzimit nr 3 datë 15.02.2001, “Mbi mbikqyrjen dhe kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i azhornuar me ”Udhezim i KM Nr 4 dt 17.05.2001, Udhezimi i KM, Nr 7 dat 21.11.2001, Udhezim i KM Nr 1 dt 22.02.2005 dhe Udhezim Nr 1. date 16.06.2011 me ndryshime etj.

Kontrrolli i punimeve te sherbimit do te behet nga grupi i ndjekjes parashikuar në kontraten e sherbimit midis Investitorit dhe Sipermarresit te sherbimit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Nr. Anal.	Emertimi I Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera/Leke
1	Man.3, Nr.217, çmime Materiale	Blerje stabilizant granulometri 0 ~ 37 mm	m3	1,298		-
2	2.37/2b	Transport materiale ndertimi deri 7-km	m3	1,298		-
3	Man.3, Nr.34, çmime Makineri	Dispozicion Grejder për punime, rrafshimi, nivelimi rruge.	o.p.	132		-

Afatet e ekzekutimit: Nga nënshkrimi i kontrates deri me 31.12.2021.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/ Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi

i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

